



GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE
NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

PRILL, VITIT MËSIMOR 2021-2022

UDHËZIM

Koha për zgjidhjen e testit është **70 minuta**.

Mos e hap testin dhe mos fillo t'i zgjidhës detyrat para se të japë leje mësimdhënësi kujdestar.

Testi **DUHET** të jetë i shkruar me laps kimik ose me stilolaps.

Shkruaj lexueshëm dhe me shkronja dore.

Nëse shkruan me shkronja shtypi, thekso shkronjën e madhe atje ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Nëse mendon se ke gabuar në zgjidhjen e detyrës, vendos një vijë të kryqëzuar (X) mbi të dhe zgjidhe përsëri.

Nuk guxon ta përdorësh korrektorin.

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test.

Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

→ është e pasaktë

→ është e palexueshme dhe nuk është e qartë

→ është e shkruar me laps grafit/të thjeshtë

→ është shkruar ose rrethuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë

ME FAT!

SHIFRA E NXËNËSIT

FAQJA E ZBRAZËT

Duke shfrytëzuar të dhënat nga tabela dhe teksti, zhvillo detyrat 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Hëna është sateliti natyror i Tokës. Ajo lëviz rreth Tokës në një rrugë eliptike, rrotullohet rreth boshtit të saj dhe së bashku me Tokën rrotullohet rreth Diellit. Rrafshi në të cilin shtrihet orbita e Hënës rreth Tokës është e prirë me 5° në raport me rrafshin e orbitës së Tokës rreth Diellit. Koha e orbitës së Hënës rreth Tokës është 27.3 ditë. Periudha e rrotullimit të Hënës rreth boshtit të saj zgjat aq sa orbita e saj rreth Tokës, në mënyrë që e njëjta anë e Hënës të jetë gjithmonë e dukshme nga Toka. Pozicioni i Hënës kur është saktësisht midis Tokës dhe Diellit quhet konjunksion apo lidhëz.

Një eklips hënor (Hëna që hyn në hijen e Tokës) mund të ndodhë vetëm gjatë hënës së plotë, dhe një eklips diellor (kur Hëna është midis Tokës dhe Diellit) mund të ndodhë vetëm gjatë hënës së re. Vëzhguesit shohin një kufi shumë të mprehtë të hijes së Hënës pasi Hëna nuk ka atmosferën e saj (graviteti i dobët).

H Ë N A	
Rrezja e satelitit	1738,14 km 0,273 x rrezja e Tokës
Masa	$7,348 \cdot 10^{22}$ kg 0,012 x masa e Tokës
Dendësia mesatare	$3346,4 \text{ kg/m}^3$
Nxitimi i gravitetit	$1,622 \text{ m/s}^2$ 0,1654 g
Periudha e orbitës rreth Tokës	27,32 ditë
Periudha e rrotullimit (rreth boshtit të saj)	27,32 ditë
Distanca më e madhe nga Toka (apogjej)	405696 km 0,0027 AJ
Distanca më e shkurtër nga Toka (perigjej)	363104 km 0,0024 AJ
Ekscentriciteti (zgjatimi) i trajektores	0,0549

1. Nëse pohimi është i saktë, rretho S, ndërsa nëse nuk është, rretho P.

- | | | |
|--|---|---|
| 1. Një eklips hënor ndodh vetëm gjatë hënës së re. | S | P |
| 2. Hëna është sateliti natyror i Tokës. | S | P |
| 3. Trajektorja hënore nuk është e zgjatur. | S | P |
| 4. Distanca më e vogël e Hënës nga Toka është 363104 AJ. | S | P |
| 5. Masa e Hënës është 0,012 x masa e Tokës. | S | P |

1 pikë

2. Shpjegoni pse e njëjta anë e Hënës është gjithmonë e dukshme nga Toka.

1 pikë

3. Hëna nuk ka atmosferën e saj:

1. sepse ka një kufi të mprehtë të hijes.
2. sepse e ka masën $7,348 \cdot 10^{22}$ kg.
3. sepse ka një gravitacion të dobët.

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë	
--------	--

4. Teksti i parë është shkruar me stilin gazetaresk. (Rretho PO ose JO dhe argumentoje zgjedhjen tënde)

PO JO

Argumentoje përgjigjen.

1 pikë	
--------	--

5. Apogjej është:

1. pozicioni i Hënës kur është pikërisht ndërmjet Tokës dhe Diellit.
2. pika në të cilën Hëna është më e largët nga Dielli.
3. periudha e rrotullimit të Hënës rreth boshtit të saj.

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë	
--------	--

6. Shkruaji tekstet e mëposhtme në vendin e duhur në tabelë.

**biografia, romani, udhëpërshkrimi, raporti, kënga, fabula, komenti,
ditari, lajmi, poezia refleksive**

LLOJI LETRAR - ARTISTIK	LLOJI KALIMTAR SHKENCOR - LETRAR	LLOJI GAZETARESK

2 pikë	
--------	--

Lexo vargjet dhe pastaj përgjigju në pyetjet 7, 8, 9, 10 dhe 11.

*Kujdes me fjalën
Kujdes me fjalën, zonjës me çantë
Kujdes me fjalën dhe ti zotëri
Pushteti i fjalës është i veçantë
Gatuan male dhe kakërdhi.*

*Me fjalën rrjedhin përrenj me mjaltë
Pikojnë çezma me helm të zi
Kujdes me fjalën zonjës me çantë
Kujdes me fjalën dhe ti zotëri!*

*Nga fjala humbën Judë e Pilatë
Strategë e mbretër me mbretëri
Kujdes me fjalën zonjës me çantë
Kujdes me fjalën dhe ti zotëri!*

*Kur fjala nxirret nga buzët jashtë
Si dallëndyshja s'vjen në shtëpi
Kujdes me fjalën zonjës me çantë
Kujdes me fjalën dhe ti zotëri!*

*Unë fjalën vetë e shtroj në kartë
Dhe brenda syve se ç' është e di...
Kujdes me fjalën zonjës me çantë
Kujdes me fjalën dhe ti zotëri!*

7. Autori i kësaj poezie është:

1 pikë

8. Trego kush i thotë këto vargje.

1 pikë

9. Shkruaj lajtmotivin e poezisë.

1 pikë

10. Në strofën e tretë poeti përdor rimën e:

1. alternuar
2. kryqëzuar
3. përputhur

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

11. A) Çfarë shprehet në vargjet e errësuara?

1 pikë

B) Shpjego domethënien e dy strofave të para.

2 pikë

12. Pranë vargjeve shkruaje llojin e strofës.

A) *Lodhë prej vegësh, prej rrangësh shpijet,
si u ba natë, ndej Zoga n'votër;
ndej m'u xe me dru dullijet
që kish ba n'për mal, pa motër!* _____

(Zoga, Ndre Mjeda)

B) *Sjellin makina bujqësore,
Televizorë e lavatriçe
Çdo gjë që ka Evropa tepër* _____

(Mërgimi, Din Mehmeti)

2 pikë

13. Në fragmentin (*Princi i Vogël*, Antoine de Saint-Exupery) identifikoj dy forma të shprehjes artistike.

Kështu që unë e pashë këtë shfaqje me sy hapur. Mos harroni se isha mijëra kilometra larg çdo vendbanimi. Dhe njeriu i vogël nuk dukej se kishte humbur rrugën, as nuk ishte i lodhur, i uritur, i etur apo i frikësuar. Ai nuk dukej si një fëmijë i humbur në mes të shkretëtirës. Kur më në fund arrita të flas, thashë:

- Por... çfarë po bën këtu?

Më pas më përsëriti me qetësi, shumë seriozisht:

- Të lutem ... më vizato një dele

_____ ; _____.

2 pikë	
--------	--

14. Lidh me vijë emrin e figurës stilistike me shembullin përkatës. Kujdes, një figurë stilistike është e tepërt.

personifikimi

Muji ngriti mbi shpatullat e tij shkëmbin.

krahasimi

Ç'ke flamur që s'valon?/Jam sëmure e po rënkoj...

antiteza

E ka qerpikun si krahu i dallëndyshes.

hiperbolë

Se të qante kur të qeshnin.

epiteti

2 pikë	
--------	--

15. Lidh me vijë titullin e veprës letrare me autorin e saj. Kujdes, emri dhe mbiemri i një autori është i tepërt.

Si e gjeti Ago Jakupi rrugën e zotit

Lasgush Poradeci

Yjtë e zemrës

Anton Pashku

Kulla

Mitrush Kuteli

Sami Frashëri

2 pikë	
--------	--

16. Nënvizoj fjalën e shkruar saktë.

A) aviacjoni

avjacioni

aviacioni

1 pikë	
--------	--

B) shpërbëj

shprbëj

çpërbëj

1 pikë	
--------	--

17. A) Cakto rasën e fjalëve të nënvizuara.

Artës fare nuk i këndohej. _____

Qyteti i Ulqinit është i bukur. _____

Shëtitja të bën mirë. _____

2 pikë

B) Me anë të fjalëve të dhëna, duke i radhitur fjalët drejt, formo një fjali sipas rregullave gramatikore.

e Luginës, e tharjes, punimet, ditë, së kënetës, në fushë, u kryen, këto.

1 pikë

18. A) Gjeje në fjalinë e mëposhtme pjesën e nënrenditur.

Kur pushimet mbaronin, ne të gjithë sikur prisheshim.

1 pikë

B) Ç' lloj fjalie është pjesa e nënrenditur?

1 pikë

19. A) Rretho numrin para fjalës së shkruar saktë.

1. shtrembroj
2. dadhdis
3. zdrukhtari
4. shpupurish

1 pikë

B) Fjalët e shkruara gabim shkruaj saktë.

2 pikë

E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test: _____

Nota: _____

KOMISIONI:

VLERËSUESI KRYESOR: _____

Data _____ 2022